

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Shtator, 2020**

Komunikim i vazhdueshëm mes SBASHK dhe MASH


Angazhime të përbashkëta për realizimin e kërkesave të kohës



SBASHK dhe MASH kanë vlerësuar se është i domosdoshëm komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi në shërbim të arsimit dhe realizimit të kërkesave të drejtë të punëtorëve në këtë sektor të rëndësishëm sidomos në situatën e vështirësuar nga Covid-19. Në këto takime kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinаторin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë njoftuar Ministrin Likaj dhe kabinetin e tij për ... (faqe 4)

Komunikim i vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Unitet i plotë në frontin e përbashkët të angazhimeve



Krahas takimeve të shumta me përfaqësues të ... (faqe 8)

Bashkëpunim korrekt edhe me institucionet komunale të arsimit

SBASHK-u vizitoi DKA-në e Prishtinës



SBASHK-u me qëllim të krijimit të ... (faqe 9)

Intervistë me libërmbajtësën në SBASHK - Nezafete Jakupi


SBASHK -u zë unik i të punësuarve në arsim



Nezafete Jakupi ... (Faqe 3)

Stafi qendror i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësë

Angazhime të shumta, përkushtim në rrjedhën e mbarë të trajnimeve



Cikli i dytë e trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut ka nisur më 27 gusht për të ... (faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Urojmë për rrjedhë të mbarë të vitit shkollor



Ishte lexuar drejt apeli i SBASHK-ut që mësimi mos të nis më 1 shtator sepse nuk ishin bërë gjithë përgatitjet e duhura. MASH dhe institucionet tjera analizuan edhe një herë situatën dhe vendosen që fillimi i vitit të ri shkollor të shtyhej për disa ditë dhe të shtohet mobilizimi e angazhimi për të bërë përgatitjet e duhura. Kjo kohë iu shfrytëzua për këtë qëllim dhe më 14 shtator nisi viti shkollor sipas planit të MASH. Fillimi ishte i mbarë dhe më 21 shtator shkollave iu kthyen edhe nxënësit e mësimdhënësit e tjerë.

Angazhimi maksimal i të gjithëve ka bërë që procesi mësimor të ketë rrjedhë të mbarë. Ka edhe raste të të prekurve nga Covid dhe po merren masa konkrete. Procesi mësimor vazhdon e aty ku duhet po merren masa për të vazhduar mësimi sipas skenarëve të përgatitura e të aprovuara nga MASH dhe palët tjera që janë të ndërlidhur me arsimin.

SBASHK-u është në angazhim të vazhdueshëm dhe po përcjell situatën duke apeluar vazhdimisht për kujdes dhe respektim të masave të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe MASH.

Urojmë dhe angazhohemi për rrjedhë të mbarë të vitit të ri shkollor.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.


Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 38 - 226 940



Intervista

Intervistë me libërmbajtesën në SBASHK - Nezafete Jakupi
SBASHK -u zë unik i të punësuarve në arsim



Nezafete Jakupi është pjesë e stafit qendror të SBASHK tani e 15 vite. Gëzimin, por edhe shqetësimet që sjellin kohët di t'i shpreh përmes vargut poetik. Kjo mbase ka ndikuar që ajo të studiojë letërsinë dhe gjuhën shqipe. Ajo natyrshëm ndjehet krenare për arritjet e SBASHK-ut. Atë pak kush e njeh me emrin e plotë sepse

për të gjithë ajo është Nezi.

Arsimimi Sot:

Kush është Nezafete Jakupi?

Nezafetja:

Quhem Nezafete Jakupi, jam lindur në Shallc të Vushtrrisë, Shkollen Fillore tetë vjeçare e kam mbaruar në dy shkolla, në dy fshatra, katër vite në vendlindje në Sh.F „Abdyl Frashëri“ ndërsa katër vite të tjera në Shkollën Fillore „Emin Duraku“ në fshatin Vërri, kurse Shkollën e Mesme Teknike në „Muharrem Bektesh“ në Vushtri.

Studimet i kam mbaruar në degën „Gjuhë dhe Letërsi Shqipe“ në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës „Hasan Prishtina“ si dhe vite më vonë kam vazhduar Master në drejtimin „Master në Menaxhment“ në Kolegjin „Universum“ në Prishtinë. Pra kam qenë aktive gjatë tërë kohës në arsimimin personal, kam bashkëpunuar me Vetaranët e Arsimit në kursin për „Shkrim Lexim“ i cili është organizuar për femrat e paarsimuara, kam punuar në oragnizatën për hulumtime „Index Kosova“ dhe jam e punësuar prej shumë vitesh në SBASHK, pra ku jam edhe tani.

Arsimimi Sot:

Disa fjalë për organizatën ku punoni, pra për SBASHK-un?

Nezafetja:

Është kënaqësi dhe nder, por është edhe përgjegjësi të flasësh për këtë organizatë, në të cilën jam e punësuar pothuaj prej 15 vitesh, dhe ndjej se jam rritur e formuar si personalitet këtu. Tani mund të flas pa modesti, SBASHK-u ka një mjedis kulturor të përbërë nga vlerat, besimet, qëndrimet dhe sjelljet e përbashkëta nga ku edhe buron uniteti i zërit të anëtarësisë së saj, është një organizatë që shikon intersin e të gjithë antarëve të saj, dhe jo intersin personal. Unë mendoj, se sot në Kosovë është privilegj të jesh anëtar/e, apo bashkëpunitor/e i/e SBASHK-ut, ngase mund të them është e vetmja sindikatë që me shumë seriozitet e me të drejt i merrë çështjet apo problemet edhe i qon përpara drejt një zgjidhje të drejt të tyre, dhe nuk zmbropset dhe nuk i zënë punët në asgjë, por përgjigjet aty ku kërkon nevoja dhe detyra. Pra, SBASHK-u nuk lutet por punon!

Arsimimi Sot:

Ju punoni prej vitesh në SBASHK, çka mendoni për menaxhimin dhe bashkëpunimin në SBASHK?

Nezafetja:

Menaxhimi çdoherë kërkon pëpjekje dhe energji për të krijuar ambiente të mira pune nga udhëheqësit apo menaxherët, e kjo në SBASHK, mendoj se është shembull për së mbari për tu marr edhe nga organizata tjera, ngase ne si punëtorë ngazëllemi për punët tona, ne në çdo kohë mund të pyesim apo të shprehim mendimin tonë tek udhëheqësi apo dhe menaxheri, nga të cilët dëgjohemi me kujdes, dhe normalisht marim përgjigjen çdo here, këtu punojmë shumë, jemi krenarë për punën që bëjmë, bashkëpunojmë të gjithë mes vete, besojmë shumë tek njeri tjetri, dhe mbi të gjitha respektojmë njëri tjetrin. Dhe normalisht se pa manxher të mirë edhe SBASHK-u nuk do të ishte ku është tani. Nuk thuhet kot, bashkimi bënë fuqinë.

Arsimimi Sot:

A mundeni të na thuani, se sa ka ndikuar pandemia në punën tuaj?

Nezafetja:

Tani po flasim për diçka që është aktuale, normalisht që kjo pandemi mendoj, se jo vetëm tek unë por te të gjithë ka ndikuar shumë negativisht, ne kemi punar edhe nga shtëpia, në bashkëpunim me stafin në mënyrën online, nën menaxhimin e menaxherit Ymer Ymeri, kemi arritur që të jemi aktiv dhe të dobishëm për anëtarësinë edhe në mënyrën virtuale, ngase të gjitha shërbimet ndaj anëtarësisë ne jemi përpjekur që edhe në mënyrën online t'i dërgojmë deri në fund, aty ku është dashur të ofrohen.

Uroj që të kthehemi shumë shpejt në normalitet ne e e gjithë bota.

Arsimimi Sot:

Ju na thatë se punoni prej vitesh në këtë organizatë-SBASHK, çka mendoni, cili është motivi i të qëndruarit prej 15 vitesh në këtë organizatë?

Nezafetja:

Mendoj dhe besoj se suksesi është motivi kryesor për të parë sa më larg, për të arrit qëllimet. Mendimi i të qënurit i dobishëm për punën që e bënë, të jep vullnet e guxim që të vazhdojnë tutje. Të ndjehesh e vlerësuar dhe e respektuar për atë që bënë është privilegj dhe respekt, ku besoj se kjo është reciproke për

organizatën dhe punëtorin. Pra prej vitesh që punoj këtu jam ndjerë dhe ndjehem e vlerësuar, dhe kjo më bënë që të jap nga vetja më të mirën në dobi të punës dhe SBASHK-ut.

Arsimimi Sot:

Sa e lexoni gazetën elektronike të SBASHK-ut „Arsimimi Sot” ?

Nezafetja:

Unë leximin e kam pasion, edhe gazetën mujore „Arsimimi Sot” e lexoj në kohë të lirë, lexoj të gjitha faqet, por gjithnjë ndalem edhe tek editoriali dhe intervista, që të dyja keto i lexoj me ëndje.

Kjo gazetë është edhe një mjet informimi nga e cila mund të shohim e gjithë aktivitetet e takimet e rëndësishme të SBASHK-ut të përmbledhura në një gazetë elektronike dhe të jemi çdo herë të informar kudo ku jemi.

Arsimimi Sot:

Nëse doni të thoni ndonjë gjë për fund?

Nezafetja:

Ju faleminderit që më zgjodhët për këtë intervistë, ishte kënaqësi për mua që të jem e pëfshirë në të. Tani të gjithë lexuesve iu dëshiroj suksese dhe gjithë të mirat, me një shprehje të bukur e të huazuar: Mendja e një kombi është arsimit, zemra e tij është morali i përgjithshëm. Pra, arsimimi duhet të jetë prioritet i shtetit.

Gjatë muajit

Komunikim i vazhdueshëm mes SBASHK dhe MASH

Angazhime të përbashkëta për realizimin e kërkesave të kohës

SBASHK dhe MASH kanë vlerësuar se është i domosdoshëm komunikimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi në shërbim të arsimit dhe realizimit të kërkesave të drejtë të punëtorëve në këtë sektor të rëndësishëm sidomos në situatën e vështirësuar nga Covid-19. Në këto takime kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për

organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë njoftuar Ministrin Likaj dhe kabinetin e tij për përkushtimin e SBASHK-ut në rrjedhën e mbarë të procesit mësimor dhe për qëndrimet e kërkesat e anëtarësisë. Ishte vlerësim i përbashkët se pas shtyrjes së fillimit të vitit të ri shkollor janë bërë përgatitje në shumicën e shkollave, gjë të cilën e kanë vërejtur nga afër gjatë

vizitave të përbashkëta në disa prej institucioneve shkollore.



Po ashtu është bashkëbiseduar dhe ishte angazhim i përbashkët që mësimdhënësit me sëmundje të rënda duhen liruar nga procesi mësimor duke u dhënë paga gjatë gjithë muajve të këtij viti shkollor dhe të shikohet mundësia për një zgjidhje të qëndrueshme për këta kolegë.

Një angazhim i përbashkët i SBASHK dhe MASH në këto takime është edhe gjetja e një zgjidhje të pranueshme për kolegët tanë që janë në sistemin arsimor e që kanë 180 kredi. Kjo çështje është aktuale dhe MASH sigurisht që do të gjej zgjidhje të duhur, që këta mësimdhënësit të përcjellin programet studimore pa shkëputje nga puna.

Kishte takime në të cilat ishte i pranishëm edhe zv/ministri Xhavit Rexhaj dhe anëtarë të tjerë nga kabineti i Ministrit, Këshilltari i lartë Enver Osdautaj dhe Shefi i kabinetit Gëzim Berisha. Të gjithë kanë treguar përkushtim të njëjtë dhe gatishmërinë për bashkëpunim të vazhdueshëm me SBASHK-un e në shërbim të arsimit. Dëshmi e bashkëpunimit korrekt dhe përkushtimit në shërbim të arsimit është edhe vizita që të dy palët ua kanë bërë disa prej institucioneve arsimore.



Komunikimi SBASHK –MASH është i vazhdueshëm me takimet e rregullta të përfaqësuesve të kabinetit të Ministrit Likaj me përfaqësues të SBASHK-ut duke

koordinuar angazhimet dhe duke bërë përgatitje për realizimin e çështjeve konkrete .

Kështu ishte edhe më 28 shtator kur kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me Gëzim Berishën, shef i Kabinetit të Ministrit Likaj dhe me Enver Osdautaj, Këshilltarin e lartë të Ministrit.



Të dy palët kanë këmbyer informacione duke bërë analizën e rrjedhës së procesit mësimor duke vlerësuar se situata është stabile dhe se po vazhdohet me angazhimet e përbashkëta për respektimin në tërësi të këshillave të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe të Udhëzimeve të MASH.


Edhe në këtë takim SBASHK-u ka ngritur çështjen e kolegëve të sëmurë rëndë dhe ishte vlerësim i përbashkët se institucionet lokale duhet të vënë në zbatim çështjen e mësimdhënësve me sëmundje të rënda, gjegjësisht që ata të lirohen nga procesi mësimor për këtë vit mësimor pasi që për ta MASH përmes Qeverisë ka siguruar mjete për pagat e tyre dhe në vend të tyre të angazhohet personel tjetër arsimor. SBASHK-u në këtë takim ka cekur edhe çështjen e Udhëzimit Administrativ 10/2018 lidhur me mësimdhënësit që janë në sistemin arsimor me 180 kredi . Të dy palët kanë kujtuar se Ministri Likaj e ka ngritur këtë çështje, e cila edhe do të gjej zgjidhje të drejt duke u përmirësuar Udhëzimi në fjalë dhe duke u krijuar kushtet në Fakultetin e Edukimit në Prishtinë dhe në fakultetet gjegjëse në komunat tjera që të punësuarit në sektorin e arsimit të ndjekin studimet pa shkëputje nga puna.

Ishte mendim i përbashkët se çështjet tjera të ngritura në këto takimeve konsultative nga SBASHK-u do të diskutohen në takimin me Ministrin Likaj, që do të ndodhë së shpejti.


Stafi qendror i SBASHK-ut në shërbim të anëtarësë

Angazhime të shumta, përkushtim në rrjedhën e mbarë të trajnimeve


Cikli i dytë e trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut ka nisur më 27 gusht për të vazhduar edhe në muajin shtator. Ky aktivitet ka rrjedhë të mbarë duke iu falënderuar angazhimit të stafit qendror, kryetarëve të nivelit komunal dhe vullnetit të kolegëve tanë nga shumë komuna të Kosovës. Në vazhdimësi të këtij aktiviteti janë kryer me sukses trajnimet për kolegët tanë Lipjani, Mitrovica, Malisheva, Gjilani, Vitia, Prishtina, Dragashi, Vushtrria, Klina, Novobërda, Kaçaniku e komuna të tjera.



Ata ishin ndarë në grupe sipas këkresave të tyre në trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social", "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik", Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" dhe trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm". Për rrjedhën e mbarë të këtyre trajnimeve janë përkujdesur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me stafin qendror dhe trajnerët Blendor Shatri, Safet Beqiri, Ramadan Gashi, Sami Shala, Blerta Blakaj, Hysen Sogojeva, Besim Kryeziu, Mentor Mani dhe Pranvera Haziri.




Me të përfunduar aktiviteti me këto grupe kanë nisur trajnimet me grupe të tjera mësimdhënësish. Ata janë bërë pjesë e trajnimeve "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerin Safet Beqiri, trajnimin "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerët Sami Shala e Dren Gërguri. Grupe të tjera mësimdhënësish kanë marrë pjesë në trajnimin "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" me trajnerin Mentor Mani dhe grupi i pestë me kolegët në trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerin Blendor Shatri. Pjesëmarrës në këto trajnime kanë qenë kolegët tanë nga Malisheva, Klina, Kastrioti (Obiliqi), Lipjani, Gjilani, Prishtina, Kaçaniku, Theranda (Suhareka) Shtërpca dhe Mitrovica. Ky aktivitet ka vazhduar duke respektuar vullnetin e kolegëve tanë nga Vitia, Theranda (Suhareka), Kastrioti (Obiliqi), Klina, Malisheva, Skenderaj, Gjilani, Kamenica, Novobërda, Lipjani, Deçani, Dragashi, Kaçaniku e Klllokoti të ndarë në grupe me trajnimet "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar" me trajnerët Skënder Gashi, Valentina Sopjani e Jehona Oruqi.




Kolegë të tjerë kishin shprehur vullnetin që të marrin pjesë në trajnimin "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajnerët Arbenita Hoxha e Hysen Hyseni. Disa nga kolegët tanë kanë kërkuar të jenë pjesë e trajnimit "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" dhe ata të ndarë në dy grupe do të përcjellin këtë aktivitet të udhëhequr nga trajnerët Pranvera Haziri e Arbëresha Aliu.


Shumë nga kolegët tanë kanë përcjellë trajnimin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" me trajnerët Emrush Ahmeti e Blerim Mehmeti.



Në fillim të trajnimit për çdo grup janë kyçur edhe kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Kryetari i SBASHK-ut ka përgëzuar gjithë kolegët dhe trajnerët për zellin e treguar dhe ka lavdëruar përkushtimin e koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafit qendror për organizimin me sukses të këtij aktiviteti dhe për përkushtimin e vazhdueshëm në aktivitetet në shërbim të anëtarësisë. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe nënkryetarja Vjollca Shala kanë bashkëbiseduar me pjesëmarrësit lidhur me rrjedhën e trajnimeve dhe u janë përgjigjur pyetjeve të pjesëmarrësve lidhur me çështje sindikale. SBASHK-u është duke analizuar idenë që varësisht nga situata në institucionet arsimore të organizojë trajnimet në shkolla kudo në komunat e Kosovës.



Dëshmi se idetë e SBASHK-ut janë të qëlluara e në shërbim të arsimit

Strategjia nacionale për arsimin duhet të jetë e përgatitur mirë

Ishte viti 2019 kur SBASHK-u kishte alarmuar publikisht për gjendjen e krijuar në Kamenicë nga nisja e angazhimit të kryetarit Kastrati lidhur me shkollat dhe arsimin në këtë komunë. SBASHK-u vizitoi shumë fshatra të Kamenicës dhe u bëri apel publik deputetëve dhe institucioneve qendrore që të shkojnë atje dhe ta shohin e vlerësojnë situatën nga afër. Pak e hiç u angazhuan ata dhe SBASHK-u arriti marrëveshje të shkruar me kryetarin Kastrati, marrëveshje kjo që mbron punëtorët e arsimit që të mos hidhen në rrugë pas dekadave të punës në arsim.

Kjo çështja e arsimit në Kamenicë u riaktualizua përsëri dhe mirë që ndodhi. Kryeministri Hoti u takua me kryetarin Kastrati dhe duke e lavdëruar atë e pastaj deklaroi se vendit i nevojitet një strategji nacionale e reformimit të sistemit Arsimor

Parauniversitar. Këtë që e ka thënë tani kryeministri Hoti për një strategji nacionale për arsim ishte kërkuar që moti nga SBASHK-u me qëllimin e vetëm që të mos ndodhin vazhdimisht e për 20 vite me radhë eksperimente në arsimin tonë, po të krijohet nga Akademia e Shkencave, nga njohësit më të mirë të arsimit që do t'i caktonin partitë parlamentare dhe nga përfaqësues të SBASHK-ut. Kjo strategji pastaj do të ishte bazë e angazhimit e cilitdo të që fiton në zgjedhje për të udhëhequr shtetin tonë.

SBASHK-u vlerëson qartë se Strategjia e krijuar nga gjithë këto palë nuk do ta kishte bazë mbylljen e shkollave, por do ta kthente arsimin në prioritet dhe do ta lironte nga ngulfatja që po i bën politika. Kjo Strategji do t'i obligonte institucionet që të financojnë në arsim dhe shkollat tona nuk do ta kishin më mjet

kryesor të punës shkumësin dhe shpuzën. Kjo Strategji duhet të jep përgjigje të saktë çka me nxënësit, çka me mësimdhënësit? Kjo Strategji do ia kthente autonominë shkollës dhe lirinë akademike punëtorëve të arsimit. Kjo Strategji do të rregullonte mirë e drejtë të gjitha çështjet dhe do të ishin obligative për zbatim pavarësisht se cila parti fiton në zgjedhjet lokale a qendrore. Strategjia nacionale duhet të jep përgjigje konkrete në këto dhe gjithë çështjet tjera që ndërlidhen me arsimin dhe me të punësuarit në këtë sektor të rëndësishëm.

Komunikim i vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve


Unitet i plotë në frontin e përbashkët të angazhimeve

Krahas takimeve të shumta me përfaqësues të institucioneve, stafi qendror i SBASHK-ut ka mbajtur takime nga larg dhe komunikim të vazhdueshëm me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve me qëllim të informimit të ndërsjellë për situatën aktuale, gjendjen në institucionet arsimore dhe për kërkesat konkrete të anëtarësisë.

Në këto takime dhe në komunikimin e vazhdueshëm kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm kanë ndarë informacione me kryetarët në kohën më të shpejtë të mundur duke treguar për rrjedhën e takimeve me Ministrin Likaj, zv/ministrin Rexhaj dhe anëtarët e tjerë të kabinetit të Ministrit, por edhe lidhur me qëndrimet e diskutimet në takimet e mbajtura të sekretarit të përgjithshëm të MASH, Agim Bërdynaj me drejtorët e DKA-ve, e në të cilat takime ishin edhe Ministri Likaj e zyrtarë të tjerë të lartë nga Qeveria e Kosovës.



Kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve kanë përgëzuar stafin qendror për angazhimet në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë dhe kanë dhënë informacione lidhur me gjendjen aktuale në institucionet arsimore të komunave të tyre dhe në Universitete duke përcjellë edhe propozimet, pyetjet idetë e anëtarësisë për angazhimet e SBASHK-ut. Gjatë gjithë këtij komunikimi mbetet vlerësim i përgjithshëm se viti i ri shkollor do të jetë me plot sfida dhe kërkon prandaj angazhim të vazhdueshëm nga të gjitha palët. Në këtë takim të SBASHK-ut me kryetarët e nivelit komunal sindikal janë caktuar detyra konkrete për gjithë veprimtarët sindikal, por edhe është vendosur për kërkesat konkrete drejtuar DKA-ve dhe institucioneve tjera. Njëra nga detyrat konkrete është që kryetarët e shoqatave sindikale në të gjitha institucionet arsimore në Kosovë të vëzhgojnë vazhdimisht zbatimin e masave të përcaktuara nga Instituti i Shëndetit Publik dhe MASH dhe të raportojnë vazhdimisht për situatën ekzistuese.



SBASHK-u edhe nga ky takim publikisht u është drejtuar DKA-ve me kërkesat që gjatë javës së parë me të nisur mësimi të lidhin kontrata shtesë me mësimdhënësit që do të angazhohen me norma shtesë. Duhet saktësuar lista e mësimdhënësve të sëmurë rëndë që lirohen nga procesi mësimor duke i siguruar ata se do të vazhdojnë të marrin pagën. Kryetarët e nivelit komunal dhe stafi qendror kanë përsëritur vërejtjen se nuk duhet angazhuar mësimdhënësit për matjen e temperaturës së nxënësve. Po ashtu është

kërkuar që në institucionet arsimore me numër të madh të nxënësve të sigurohet prani e personelit mjekësor për ta përcjellë situatën nga afër. Janë caktuar edhe detyra të tjera konkrete, që po realizohen në vazhdimësi dhe është marrë vendimi që të vazhdohet me organizimin nga larg të trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut për kolegët tanë nga e tërë Kosova e duke u bazuar në kërkesat dhe vullnetin e tyre për të qenë pjesë e këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Bashkëpunim korrekt edhe me institucionet komunale të arsimit

SBASHK-u vizitoi DKA-në e Prishtinës

SBASHK-u me qëllim të krijimit të një atmosfere mirëkuptimi dhe të angazhimit të përbashkët për gjetjen e zgjidhjes së drejtë për të gjitha çështjet aktuale, ka vazhduar me bashkëpunimin korrekt edhe me institucionet lokale të arsimit. SBASHK-u ka komunikim korrekt e të vazhdueshëm me kryetarin e Kolegjiumit të Drejtorëve të Arsimit, Besim Avdimetaj dhe me drejtorë të tjerë të DKA-ve.



Në kuadër të këtij angazhimi SBASHK-u ishte pjesë e takimeve të DKA-ve për të debatuar për gjendjen në arsim dhe për angazhimet e përbashkëta. Po ashtu ka nisur edhe me vizitat në DKA. Vlen të përmendet vizita në DKA-në e Prishtinës dhe takimi me të parën e këtij institucioni arsimor Shpresa Shala.

Drejtorja Shala është shprehur e kënaqur me bashkëpunimin korrekt me SBASHK-un dha treguar për angazhimet e shumta që janë bërë gjatë gjithë verës në përgatitjen e Udhëzimeve konkrete e pastaj edhe me angazhimet konkrete në institucionet arsimore. Të dy palët janë pajtuar që të vizitojnë bashkërisht institucionet arsimore për të parë nga afër rrjedhën e punës atje dhe për të dëgjuar mendimet dhe idetë e personelit arsimor me qëllim të angazhimit për zgjidhjen e drejtë të të gjitha çështjeve të ngritura nga të punësuarit në institucionet arsimore të kryeqytetit.

Dita Botërore e Mësuesit shënohet ndryshe këtë vit

Për 24 orë mësuesit e tërë botës bashkëbisedojnë nga larg



Pandemia që ka goditur tërë botën ka ndikuar edhe në


mënyrën e përkushtimit dhe angazhimit të mësuesve në tërë botën. Internacionalja e Arsimit (EI) ka mbajtur vazhdimisht takime nga larg me sindikatat anëtare që përfaqësojnë 32 milionë anëtarë dhe ka mundësuar komunikimin dhe këmbimin e ideve e përvojave arsimore në kushte pandemie. Viteve të kaluara EI mbështeste aktivitetet kushtuar Ditës Ndërkombëtare të mësuesit 5 Tetorit dhe shumë nga aktivitetet organizoheshin edhe nga SBASHK-u, si anëtare e EI-së. Situata me pandeminë ka bërë që këtë vit kjo datë e rëndësishme për arsimin të shënohet

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

ndryshe, por mësuesit e botës edhe përkundër kësaj do të dëgjohen e do të bashkëbisedojnë nga larg përmes një aktiviteti të organizuar nga sekretari i përgjithshëm i EI-së David Edwards dhe stafi tjetër qendror. Pjesë nga parapërgatitjet për këtë aktivitet po përcjellim deri të ju lexues të nderuar.

Regjistrimi është i hapur për të gjithë mësimdhënësit kudo, andaj bashkohuni me 5 tetor duke u regjistruar në këtë mënyrë:

Klikoni ne webfaqen www.5oct.org, posa te hapet, klikoni *Click here to register*, pastaj plotesoni të dhënat që kërkohen. Pasi të regjistroheni, kontrolloni emailin tuaj ne JUNK / SPAM në mënyrë që të bëni verifikimin e regjistrimit, në emailin që iu dërgon Education International.



#WorldTeachersDay

Taking the lead

24h with teachers around the globe
Register today at www.5oct.org
Watch live on **October 5th** | **#5octlive**

